



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2313/3 Prot

Datë 25.11.2021

**VENDIM**

**K.P.P. 949/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.11.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” SHPK & “BE-IS” SHPK në procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Rindërtimi i “Ures Se Zeze” Mbi Lumin “Drin” Dhe Rehabilitimi I Rrugës “Inxhinier Gjadri”, Lezhe, me nr. REF-09564-10-26-2021, me fond limit 290,013,771, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

**Ankimues:** BOE “Curri” SHPK& “BE-IS” SHPK  
Rruga “Kajo Karafili”, Nd.2, H.4, Ap.3, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Lezhë  
L. Skenderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligji nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.10.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Rindërtimi i “Ures Se Zeze” Mbi Lumin “Drin” Dhe Rehabilitimi I Rruges “Inxhinier Gjadri”, Lezhe, me nr. REF-09564-10-26-2021, me fond limit 290,013,771, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 15.11.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 18.11.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezultoni si më poshtë vijon:

- 4 A-M I kualifikuar
- BOE Curri&BE-IS I skualifikuar
- GPG Company I kualifikuar

II.4. Në datën 18.11.2021 BOE Curri SHPK& BE-IS SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "CURRI" Shpk, me Nuis J67902718S & "BE-IS" Shpk, me Nuis K71412003A, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoni se: Ne piken 1/c, te kushteve te veçanta te kualifikimit, te Dokumentet Standarde te Tenderit, miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 225, date 12.04.2021 "Per nje ndryshim ne vendimin nr. 199, date 04.03.2020, te Keshillit te Ministrave, "Per miratimin e dokumenteve standarde te procedures se prokurimit, te kriterave te vleresimit te ofertes fituese, kushteve te marreveshjes kuader dhe te kontrates per procesin e rindertimit", te ndryshuar dhe dokumentet standarde te procedures ne kuader te procesit te rindertimit", parashikohet se:
  1. Ofertuesi duhet te paraqesë: c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5; Gjithashtu ne nenin 83, te ligjit nr.1 62/2020 "Per prokurimin publik", parashikohet se: 1. Autoriteti kontraktor duhet te kërkojë paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit, me përjashtim te procedurave te prokurimit me vlerë te vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet te kërkojë paraqitjen e sigurimit te ofertes ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund te kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe ne procedurat nen kufirin e lartë monetar, me përjashtim te procedurave te prokurimit me vlerë te vogël. Si dhe ne nenin 30, te VKM-se 285, date 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", parashikohet se: "1Autoriteti kontraktor duhet te kërkojë paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit, me përjashtim te procedurave te prokurimit me vlerë te vogël, sikurse përcaktohet ne nenin 83, te LPP-së. Enti kontraktor duhet te kërkojë paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit, me përjashtim te procedurave te prokurimit me vlerë te vogël, sikurse përcaktohet ne nenin 83, te LPP-së. Enti kontraktor, sipas vlerësimit te tij, mund te kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nen kufirin e lartë monetar. 2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga*

ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”, Sa me sipër KVO, vlereson se për të përmbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e cila duhet të jete e neshkruar nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit. Për më tepër ky kriter veçanërisht është i shtuar në procedurat në kuader të procesit të rindertimit dhe është vendosur nga autoritetet perkatese në DST, të kriteret e vecanta (shtojcat), të cilat nuk mund të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Mospërmbushja e këtyre kriterëve përben shkak për skualifikimin e ofertuesve. Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE, rezulton se BOE nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertës sipas shtojces 5, duke e bërë të papërmbushur këto kriter.

2. Se dyti në piken 1/gj, të kushteve të vecanta parashikohet se: Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri KVO verën se, për përmbushjen e këtij kriteri Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike përfshirë ku në rastin konkret përfshihet edhe muaji Shtator 2021. Nga verifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit rezulton se ky Operator Ekonomik ka paraqitur dokumentacion që vërteton shlyerjen e detyrimeve të energjisë por pa përfshirë muajin Shtator 2021. Si rrjedhojë ky kriter konsiderohet i pa përmbushur nga ana e OE.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 76, pika 3/a dhe nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik “CURRI” Shpk & “BEIS” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese. Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “CURRI” Shpk, me Nuis J67902718S & “BE-IS” Shpk, me Nuis K71412003A, skualifikohet.

II.5. Në datën 22.11.2021, BOE ankimues “Curri&BE-IS SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me argumentet si më poshtë:

- Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit: Referuar DT seksioni 3 informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik përcaktohet si më poshtë vijon: **3.1 Kriteret e Pranimit sipas shtojcës 16:**

**3.2 Sigurimi i Ofertës:** Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, sipas Shtojcës 5. Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës së fondit / vlerës së përafërt të kontratës, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, 5,800,275.42 (pesë milion e tetëqind mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pese **pikë** dyzet e dy) Leke.

Pra pavarësisht se në DT është përfshirë edhe shtojca 5 e Formularit standard të sigurimit të ofertës AK ka vendosur si përcaktim se ofertuesit dhe kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në vlerën 2% të fondit limit. Nisur nga sa është përcaktuar në DT arsyeja e dhënë nga AK nuk qëndron pasi procedura është në fazë short listimi.

-Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit: Sic dhe jeni në dijeni dhe konstatohet ne kemi paraqitur vërtetim me nënshkrim elektronik nga FSHU , OSHEE-2021-3522748-YN datë 25.10.2021. Vërtetimi sic edhe mund të konstatohet citon se : .....rezulton të këtë në total 0 lekë detyrime ndaj FSHU. Kjo është lehtësisht e verifikueshme , pasi likuidimet bëhen të gjitha me transfertë bankare. Bashkëlidhur gjeni konfirmimet nga banka për pagesat e faturave të FSHU.

-Sa më sipër pretendimet e KVO nuk qëndrojnë.

II.6. Në datën 24.11.2021, autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin/dokumentacionin lidhur me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues Curri&BE-IS SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se *“Se dyti ne piken I/gj, te kushteve te veçanta parashikohet se: Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri KVO verën se, per përmbushjen e këtij kriteri Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve te maturuara të energjisë elektrike perfshire ku ne rastin konkret përfshihet edhe muaji Shtator 2021. Nga verifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit rezulton se ky Operator Ekonomik ka paraqitur dokumentacion qe vërteton shlyerjen e detyrimeve te energjisë por pa perfshire muajin Shtator 2021. Si rrjedhoje ky kriter konsiderohet i pa përmbushur nga ana e OE, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorëzohet:*
- *Marrëveshja e bashkëpunimit<sup>1</sup> ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

III.1.2. Në shtojcën 15 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2 gërma gj) përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” neni 14

*gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.3. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se BOE “Curri” & “BE-IS” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë bashkëpunimi për krijimin e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë midis shoqërisë Vurri SHPK dhe Be-Is SHPK me qëllim pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit me objekt “*Rindertimi i “Ures Se Zeze” Mbi Lumin “Drin” Dhe Rehabilitimi I Rrugës “Inxhinier Gjadri”, Lezhe*, zhvilluar nga Bashkia Lezhë. Në nenin 4 kontributet e palëve përcaktohet: Shoqëria Curri 60% dhe shoqëria Be-Is SHPK 40%.
- Vërtetim Debie Nr.293 prot datë 22.10.2021 për OE BE-IS SHPK me përmbajtje si vijon: *Bazuar në deklaratimet e deklaruësit vërtetohet se kërkuesi BE-IS SHPK nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratat me KOD XXXXX titullar i të cilave është BE-IS SHPK rezultojnë të kenë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 22.10.2021 duke përfshirë faturën koherente të muajit shtator 2021.*
- Vërtetim Debie OSHEE-2021-3522748-YN datë 25.10.2021 për OE Curri SHPK me përmbajtje si vijon: *Bazuar në deklaratimet e deklaruësit vërtetohet se kërkuesi Curri SHPK nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratat me KOD XXXXX titullar/përdorues i të cilave është Curri SHPK rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.10.2021 pa përfshirë faturën koherente të muajit shtator 2021.*

III.1.4. Neni 42 pika 10 i ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, parashikohet shprehimisht se: *“Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankimi administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet e-mail-it zyrtar. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.”*

III.1.5. Në nenin 42, pika 1 e ligjit nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, parashikohet se *“Kriteret e kualifikimit dhe kriteret e vlerësimit hartohen sipas legjislacionit*

*për prokurimin publik, për aq sa është e mundur dhe pa rënë ndesh me parashikimet e këtij akti.”*

III.1.6. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.*

*2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.*

III.1.7. Në nenin Neni 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.1.8. Në nenin 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publik”, pika 4,7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

*4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:*

- a) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion*



***kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.***

III.1.9. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

2. *Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.1.10. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

III.1.11. Referuar korenspondencës mbajtur midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, nga kjo e fundit është konfirmuar se, pasi bëhen verifikimet përkatëse në sistemin e faturimit, lëshohet “Vërtetim Debie” sipas formatit standart për të gjitha subjektet aplikuese. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë elektrike, evidenton saktësinë e dokumentacionit, të paraqitur nga subjektet përkatëse si dhe tërësine e kontratave, dhe në fund konkludon me lëshimin e “Vërtetim Debisë” i cili konfirmon se:

1. *Konsumatori nuk rezulton debitor në sistemin e furnizimit*
2. *Konsumatori rezulton debitor*
3. *Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.*

III.1.12. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.13. Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon se në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Gjithashtu, në fazën e vlerësimit, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë parashikimin e nenit 88, pika 3 e VKM, sipas së cilës secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, **dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit**. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në përputhje me këtë përcaktim ligjor, KPP gjykon se kriteri lidhur me shlyerjen e energjisë elektrike është një kriter i cili duhet të përmbushet nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimues rezulton se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Curri” ShPK ka dorëzuar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike pa përfshirë detyrimet e maturuara të muajit Shtator 2021. Në rastin konkret referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se faza e parë e procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit) është zhvilluar më datë 15.11.2021. Referuar datës së zhvillimit të fazës së parë të procedurës së prokurimit objekt-ankimi datë 15.11.2021, KPP gjykon se detyrimet e energjisë elektrike për muajin Shtator 2021 janë tashmë të maturuara në kuptim të përcaktimeve ligjore sa më sipër dhe afati i fundit për shlyerjen e tyre ka qenë data 31.10.2021. Në këtë kuptim referuar datës së zhvillimit të fazës së parë të procedurës së prokurimit objekt-ankimi (15.11.2021), Komisioni gjykon se, anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Curri” ShPK, nuk ka plotësuar kriterin e veçante të kualifikimit lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi. Akoma më tej sa i takon pretendimeve të ankimuesit, se ka paguar detyrimet e energjisë elektrike duke bashkëngjitur ankesës dokumentin konfirmim i pagesës automatike të faturës, KPP gjykon se kriteri i veçantë i kualifikimit kërkohet të përmbushet me anë të vërtetimit të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, vërtetim i cili në rastin konkret

është dorëzuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë Curri SHPK, por nuk vërteton shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin shtator 2021 tashmë të maturuara referuar datës së zhvillimit të fazës së parë të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Ndërsa sa i takon faturës së paraqitur bashkëngjitur ankesës, KPP gjykon se përveçse nuk është një dokument që mund të pranohet për efekt të përmbushjes së kriterit nuk jep asnjë informacion lidhur me muajin që i takojnë detyrimet përkatëse.

Sa më sipër KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” ShPK nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyen tjetër të skualifikimit të BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar arsyetimit më sipër, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e BOE ankimues do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 42 e vijues të ligjit nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” & “BE-IS” SHPK për procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Rindërtimi i “Ures Se Zeze” Mbi Lumin “Drin” Dhe Rehabilitimi I Rruges “Inxhinier Gjadri”, Lezhe, me nr. REF-09564-10-26-2021, me fond limit 290,013,771, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” & “BE-IS” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**